



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 7274/1 prot.

Tiranë, më 19. 11. 2019

VENDIM

Nr. 70, datë 19.11.2019

PËR

**NGRITJEN RAST PAS RASTI TË NJË TRUPI GJYKUES PËR SHQYRTIMIN E
KËRKESËS SË MUNDSHME NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT PËR
PËRJASHTIMIN E TRUPIT GJYKUES DHE/APO ANËTARIT RELATOR PËR
SHKAK TË KONFLIKTIT TË INTERESIT SI RRJEDHOJË E THIRRJES NË
SEANCË DËGJIMORE BAZUAR VETËM NË NJË OSE DY KRITERE
VLERËSIMI**

Në mbështetje të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të Rregullores së veprimtarisë së Komisionit, miratuar me vendimin nr. 2, datë 19.7.2017, Komisioni,

VËREN:

Nisur nga kërkesat e përsëritura të subjekteve të rivlerësimit për përjashtimin e trupit gjykues për shkak të konfliktit të interesit si rrjedhojë e thirrjes në seancë dëgjimore bazuar vetëm në një ose dy kritere vlerësimi, në përpjekje për të shmangur çdo zvarritje të mundshme të procesit, si edhe për ekonomi gjyqësore, duke marrë në konsideratë edhe mendimin e vëzhguesve ndërkombëtarë, Komisioni vlerëson si të nevojshme ngritjen paraprakisht të një trupi gjykues për të marrë në shqyrtim menjëherë kërkesat e mundshme të kësaj natyre.

PËR KËTO ARSYE,

Pas diskutimeve, bazuar në ligjin nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

V E N D O S I:

1. Ngritjen rast pas rasti të një trupi gjykues për shqyrtimin e kërkesës së mundshme nga subjekti i rivlerësimit për përjashtimin e trupit gjykues dhe/apo anëtarit relator për shkak

të konfliktit të interesit si rrjedhojë e thirrjes në seancë dëgjimore bazuar vetëm në një ose dy kritere vlerësimi.

2. Ngritja e trupi gjykues që do të shqyrtojë kërkesën, bëhet një ditë para seancës dëgjimore të njoftuar, pas njoftimit të Komisionit nga kryesuesi/relatori i trupit gjykues.
3. Afati i trupit gjykues të ngritur me short fillon me administrimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit dhe përfundon me dhënien e vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Genta Tafa (Bungo)

